

Ti konsiderohesh fëmijë nëse je nën moshën 18 vjeç



**MË DUHET NDIHMË! TË DREJTAT E TUA**

# **KU TË MARRËSH NDIHMË**



**DISA  
KËSHILLA  
DHE KONTAKTE  
TË DOBISHME PËR  
TË TË NDIHMUAR**



Bashkëfinancuar nga Bashkimi Evropian



# TI KE TË DREJTË TË FLASËSH

MIRË TË DIHET

Organizatat do të të ndihmojnë të kesh në dispozicion **mbështetje falas** (ushqim, strehim, larje, mjekë, shkollë...) dhe do të sigurojnë që të drejtat e tua të respektohen


Profesionistët (punonjësit e policisë, kujdestarët, punonjësit socialë, avokatët, gjykatësit, mjekët...) janë njerëz të cilëve mund t'u besosh

Nëse arrestohesh, ke të drejtë për **avokat falas**

Nëse nuk e flet gjuhën e vendit ku ndodhesh, ke të drejtë për **përkthyes falas**

**MOS  
NGURRO TË  
PYESËSH PËR TË  
DREJTAT E TUA DHE  
TË SFIDOSH GJËRAT  
ME TË CILAT NUK  
PAJTOHESH!**

# PA PATUR FRIKË



**MBLEDHJE TË  
DHËNASH NË  
INTERNET PËR  
VIKTIMA KRIMI  
PËR TË GJETUR  
NDIHMË DIKU  
PRANË**

**0800 22 555 30**

<http://odabs.org>



**MBËSHTETJE NË  
INTERNET PËR  
FËMIJË**

**0800 22 555 30**

<http://save-me-online.de>



**LINJA NDIHMËSE  
PËR ABUZIM  
SEKSUAL**

**0800 22 555 30**

<http://hilfeportal-missbrauch.de>



**LINJA NDIHMËSE  
PËR DHUNË  
KUNDËR GRAVE**

**08000 116 016**





## Ç'MUND TË BËJË POLICIA PËR TY?

Policia është këtu për të të mbrojtur nëse je viktimë e dhunës, apo nëse je detyruar të bësh diçka që nuk do.

- Punonjësit e policisë janë njerëz të besuar.
- Policia NUK do të të shkaktojë asnjë dëm.
- Ti NUK ke pse ndëshkohesh për diçka që ke genë i detyruar të bësh, edhe nëse është e gabuar apo kundra ligjit.

**NË RAJONIN  
E POLICISË,  
DUHET TË KËRKOSH  
PËR NJË PUNONJËS  
POLICIE TË SPECIALIZUAR  
QË KA TRAJNIM NË  
INTERVISTIMIN E FËMIJËVE.  
KA GJITHASHTU DHE  
PUNONJËS TË CAKTUAR  
POSAÇËRISHT PËR  
MBROJTJE VIKTIMASH.**

Nëse ke frikë për  
sigurinë tënde apo të  
dikujt tjetër, telefono

**112** (urgjenca mjekësore)

ose **110** (policia)

# Ç'ËSHTË TRAFIKIMI NJERËZOR?

Ti ose një nga shokët e tu mund të jeni viktimë e trafikimit pa e kuptuar.

A ke qenë në një situatë ku të është dashur të:

- bësh seks apo kryesh vepra seksuale?
- punosh (për shembull, në shtëpinë e dikujt duke kryer punë shtëpiake apo kujdesur për fëmijë, në fabrikë apo në restorant)?
- lypësh, vjedhësh ose kryesh krime?
- rritësh, mbash ose shesësh drogë?
- heqësh organet e tua për t'i shitur?
- shlyesh një 'borxh' duke punuar apo dhënë ndonjë shërbim tjetër?

A ke qenë ti/familja jote nën kërcënim?

Nëse i përgjigjesh "po" njërës prej këtyre pyetjeve, ti ose shoku yt mund të jeni viktimë trafikimi.

**TRAFIKIMI  
NJERËZOR ËSHTË  
KRIM SERIOZ  
DHE SHKELJE E TË  
DREJTAVE TË TUA. BISEDO  
ME NJË PROFESIONIST  
TË CILIT I BËSON NËSE  
JE I SHQETËSUAR, QË TË  
NDIHMOSË ME NDALJEN  
E ABUZIMIT DHE ME  
MBROJTJEN E TË RINJVE  
TË TJERË.**

## **KOK – RRJETI OJQ GJERMAN KUNDRA TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE**

Telefon:

**0049 30 / 263 911 76**

<http://kok-gegen-menschenhandel.de>  
[info@kok-buero.de](mailto:info@kok-buero.de)





- Nëse je nga një vend tjetër, mund të të duhet leje për të qëndruar në Gjermani. Kjo do të thotë se duhet të aplikosh për azil ose lejeqëndrim. Mund të aplikosh për azil me ndihmën e kujdestarit/përgjegjësit tënd.
- Do të intervistohesh prej dikujt nga Zyra Federale për Migracionin dhe Refugjatët (BAMF) ku mund të shoqërohesh nga kujdestari/përgjegjësi yt.
- Kiparasysht se nuktë duhen dokumente zyrtare apo status imigracioni për të përfituar nga sistemi i mbrojtjes së fëmijëve.

➤ Nëse nuk i ke prindërit, do të të caktohet një kujdestar për të të mbështetur. Mund të kesh besim te ai ose ajo. Nëse nuk ke kujdestar, fol me përgjegjësin ose shërbimin për mirëqenien e të rinjve.

➤ Kujdestari do të sigurohet që të të respektohen të drejtat. Kjo përfshin disponimin e kujdesit mjekësor/psikologjik, shkollës dhe strehimit të përshtatshëm. Nëse je imigrant, kujdestari yt do të mbështesë edhe procesin e aplikimit për azil.

➤ Nëse nuk ndjehesh lirshëm me kujdestarin tënd, ose nëse vë re se ai apo ajo nuk i përmbush detyrat e veta, mos ngurro të kontaktosh dikë nga shërbimi për mirëqenien e të rinjve. Ata do të të caktojnë një kujdestar të ri me të cilin do të ndihesh më rehat.

# KËTO ORGANIZATA DO TË TË NDIHMOJNË:

## LINJA TELEFONIKE PRO ASYL MBËSHTET REFUGJATËT ME PROCEDURËN E AZILKËRKIMIT

Telefon:

**0049 69 / 242 314**

[proasyl@proasyl.de](mailto:proasyl@proasyl.de)

<http://proasyl.de/beratungsstellen-vor-ort/>

## SHOQATA FEDERALE PËR TË MITUR TË PASHOQËRUAR (BUMF) këshillim individual në telefon:

**0049 30 / 82 09 743 0**

[info@b-umf.de](mailto:info@b-umf.de)

## QENDRA E SHËRBIMIT PËR REFUGJATË DHE MIGRACION (ZMF)

këshillim për refugjatë nën  
moshë:

**0049 30 / 30 39 06 52**

[info@migrationsdienste.org](mailto:info@migrationsdienste.org)





Në Gjermani, si fëmijë ti ke të drejtën për **avokat falas** dhe **mbështetje psikologjike falas**.

➤ Informacioni që do të ndash me avokatin tënd është absolutisht konfidencial. Mos ngurro t'i tregosh atij/asaj për historinë tënde, edhe nëse më parë e ke treguar ndryshe historinë.

➤ Ti ke të drejtën për përkthyes profesionist, pa pagesë, gjatë seancave gjyqësore dhe intervistave nga policia. Nëse nuk ndjehesh lirshëm me përkthyesin, mund të kërkosh një tjetër.

Punonjësit socialë janë të rritur të besuar. Puna e tyre është të të ndihmojnë ty. Ata do të të ndihmojnë të kesh në dispozicion mbështetje falas (ushqim, strehim, mjekë, shkollë...) dhe do të sigurojnë që të drejtat e tua të respektohen. Ata punojnë në vende si qendra këshillimore ose qendra rinore.



## SHËNDETËSIA

➤ Ti ke të drejtë për **mjek falas**.

## VLERËSIMI I MOSHËS

➤ Meqë je fëmijë, të vihet në dispozicion mbrojtje specifike. Autoritetet mund të duan të të kontrollojnë moshën për t'u siguruar se je fëmijë. Prandaj, është gjithnjë më mirë të thuash të vërtetën për moshën tënde.

**MUND T'I TREGOSH MJEKÛT RRETH NDONJË PROBLEMI MJEKËSOR QË PO PËRJETON.**



**KOK  
RRJETI OJQ GJERMAN  
KUNDRA TRAFIKIMIT TË  
QENIEVE NJERËZORE**

Telefon:  
**0049 30 / 263 911 76**

[info@kok-buero.de](mailto:info@kok-buero.de)  
<http://kok-gegen-menschenhandel.de>

**ORGANIZATA WEISSER RING  
OFRON TË DHËNA KONTATIMI  
PËR AVOKATË**

Telefon:  
**0049 6131 / 83 03 0**

[info@weisser-ring.de](mailto:info@weisser-ring.de)  
<http://weisser-ring.de>

**INFORMACION PËR VIKTIMAT  
RRETH PROCEDURAVE LIGJORE**

<http://zeugininfo.de>

**BPP  
SHOQATA PËR MBËSHTETJE  
PSIKOLOGJIKE NË SEANCA  
GJYQËSORE**

<http://bpp-bundesverband.de>



**SI  
MUND TË TË  
KONTROLLOHET  
MOSHA?**

Verifikim dokumentesh identifikimi /  
certifikatë lindjeje/  
dokumente udhëtimi

Intervistë me një profesionist

Ekzaminim mjekësor (nga një  
mjek me të njëjtën gjini  
si ti)

➤ Ti ke të drejtë të kundërshtosh  
rezultatit e vlerësimit të moshës.  
Kërkoji kujdestarit ose dikujt tek i  
cili ke besim që të të ndihmojë.

➤ Si refugjat, ti nuk detyrohesh të  
lejosh ekzaminimin mjekësor për  
vlerësim moshe (p.sh. me radiografi)




## NË GJERMANI ARSIMI ËSHTË FALAS


- Për fëmijët gjermanë është e detyrueshme të shkojnë në shkollë.
- Për fëmijët e huaj ekziston e drejta për të shkuar në shkollë.



Duhet t'u kërkosh profesionistëve (përgjegjësue, kujdestarëve) të të ndihmojnë të gesh një shkollë. Është me rëndësi të jesh në kontakt me të tjerë nga grupmosha jote.







Ky botim është prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajta e këtij botimi është përgjegjësi ekskluzive e ECPAT Francë dhe partnerëve të tij në projektin ReACT: ECPAT Belgjikë, ECPAT Gjermani, ECPAT Holandë dhe ECPAT MB dhe nuk mund të merret në asnjë mënyrë si pasqyrim i pikëpamjeve të Bashkimit Evropian.

